



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 30 shtator 2019.
2. Miratimi i programit trijavor të punës së komisionit 28 tetor – 15 nëntor 2019.
3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Elona Hoxha Eglantina Gjermani, Evis Kushi, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Ediola Braha, Halit Valteri, Fatmir Velaj, Adnor Shamenti, Ervin Bushati, Vasilika Hysi, Ligoraq Karamelo dhe Rudina Hajdari.

Mungojnë:

Të ftuar:

Ilir Bejko - Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komsionit për Politikën e Jashtme të datës 17.10.2019.

Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 30 shtator, miratimin e programit 3-javor të punës për periudhën 28 tetor -15 nëntor, si dhe projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare të Luftës Kundër Falsifikimit të Monedhës”.

Për të na folur për projektligjin kemi të ftuar zotin Bejko, drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Mirë se vini, zoti Bejko!

Fillojmë me miratimin e procesverbalit të datës 30 shtator.

A ka ndonjë vërejtje?

Kush është dakord me procesverbalin?

Miratohet.

Faleminderit!

Miratimi i kalendarit 3-javor të punës së komisionit të punës për datat 28 tetor-25 nëntor.

Kush është dakord me programin?

Miratohet.

Ju faleminderit!

Kalojmë te projektligji.

Zoti Bejko, na thoni dy fjalë shtruese për konventën ndërkombëtare në të cilën Shqipëria kërkon të aderojë.

Falja është për ju, zoti Bejko.

Ilir Bejko – Shumë faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Konventa është e prillit të vitit 1929 dhe është lidhur në Gjenevë të Zvicrës. Kjo konventë është nënshkruar nga Mbreti Zog.

Kërkohet ratifikimi me ligj i kësaj konvente për dy arsye madhore: së pari, konventa kërkon ndryshim të Kodit tonë Penal, pasi legjislacioni ynë, neni 183 në vijim të Kodit tonë Penal, nuk plotëson atë çfarë kërkohet nga pjesëmarrja jonë në këtë konventë dhe është artikulli nr. 3 i kësaj konvente, i cili, ndër të tjera, përveç asaj që parashikon legjislacioni ynë, kërkon edhe dënimin e veprave të tjera penale, siç është mbajtja, disponimi, futja në territorin

e një shteti të monedhave të falsifikuara apo edhe ofrimi i monedhave të falsifikuara pa u prodhuar akoma.

Përveç kësaj, nga pjesëmarrja jonë në këtë konventë kërkohet edhe krijimi i një organi qendror, i cili do të komunikojë me organet e tjera, me përgjegjësi vetëm luftën kundër falsifikimit të monedhës, shpërndarjes së monedhës së falsifikuar ose vënies në qarkullim të kësaj monedhe.

Mimi Kodheli – Dakord.

Ju faleminderit!

Ka pyetje?

Unë kam një pyetje, nëse më lejohet, para se kolegja Gjebrea të relatojë projektligjin. Pyetja ime është: aderimi i Shqipërisë në këtë konventë, do të shoqërohet pastaj me propozimet nga ana e ministrisë për ndryshimet në Kodin Penal? Nëse nuk ju kuptova gabim.

Ilir Bejko – Konkretisht, ndryshimin e nenit 183 të Kodit tonë Penal.

Mimi Kodheli – Mirë.

Kolege Gjebrea, fjala është për ju.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit edhe juve për informacionin e detajuar që dhatë!

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji, sikurse e thashë, është aderimi i Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës.

Kjo konventë është nënshkruar në Gjenevë në prill të vitit 1929, sikurse u tha, me dëshirën për ta bërë më efektiv parandalimin dhe dënimin e falsifikimit të monedhës.

Nëpërmjet aderimit në këtë konventë synohet bashkëpunimi midis vendeve anëtare dhe shkëmbimi i informacionit. Ky informacion parashikohet përmes një zyre qendrore, e cila ka si mision centralizimin e gjithë informacionit dhe lehtësimit kështu të hetimit, parandalimit dhe dënimit të falsifikimit të monedhës.

Aderimi në këtë konventë, siç e parashikon edhe neni 23 i Kushtetutës, nënkupton që legjislacioni i palëve kontraktuese dhe organizimi i saj administrativ të jenë në përputhje me rregullat që ka kjo konventë.

Unë nuk po futem në detaje, për sa u përket atyre që ka kjo konventë. Ju e keni të gjithë në relacion dhe, pa dyshim, janë të rëndësishme për t'u lexuar të gjitha përcaktimet për sa i përket aderimit në këtë konventë.

Kjo nuk ka efekt financiar në buxhetin e shtetit dhe është e rëndësishme për t'u theksuar, pasi zyra qendrore do të pozicionohet në ndërtesën aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe punonjësit do të jenë pjesë e strukturës aktuale të kësaj drejtorie.

Në aspektin e teknikës legjislative plotësohen të gjitha kërkesat formale të një marrëveshjeje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Fjalën e ka kolegu Gjoni.

Ralf Gjoni – Ju falenderoj për prezantimin!

90 vjet pasi mbreti Zog ka nënshkruar konventën i kërkohet parlamentit të Shqipërisë të ratifikojë këtë konventë. Ndërkohë, me sa kuptoj, propozohet rindëryrje në Kodin Penal. Pse kjo konventë nuk është sjellë në parlament gjatë kohës që ne kemi diskutuar Kodin Penal në muajt e kaluar, por na kërkohet rindëryrje në Kodin Penal? Po bëhet edhe Kodi Penal si Kushtetuta, pra, si makinë larëse ku ndërhyhet orë e minutë për të futur rroba.

Mimi Kodheli – Zoti Bejko, fjala është për ju.

Ilir Bejko – Keni shumë të drejtë. Propozimi ka ardhur nga Ministria e Brendshme, nuk është propozim i Ministrisë së Drejtësisë, kështu që nuk kam asnjë informacion pse kjo konventë vjen pas një kohe kaq të gjatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ju lutem, ta mbarojë mendimin.

Ilir Bejko - Unë nuk jam dakord që të bëhen ndryshime shumë të shpeshta në Kodit Penal, por është një gjë organike, si çdo ligj tjetër, i cili herë pas here do të kërkojë ndryshime.

Mimi Kodheli - Fjalën e ka zonja Hajdari.

Ilir Bejko – Mund të shtoj edhe diçka?

Mimi Kodheli – Po, ju lutem!

Ilir Bejko - Do të jenë ndryshime minimale. Ne e kemi të parashikuar falsifikimin dhe vënien në qarkullim, kështu që do të shtojmë vetëm zotërimin e monedhës dhe ofrimin e monedhave të falsifikuara, në momentin që nuk janë prodhuar akoma si të tilla. Ju keni shumë të drejtë, ndryshimet e Kodit Penal nuk mund të jenë shumë ...

Mimi Kodheli – Zoti Hyseni, do të flisni ju apo t'ia japim fjalën zonjës Hajdari për xhentilesë?

Alket Hyseni – Unë kam respekt, së pari, për zonjat dhe së dyti, për opozitën.

(Diskutime pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Shumë faleminderit!

Zoti Hyseni, sikur të kishit të njëjtin respekt në të gjitha komisionet do të ishte shumë mirë.

Faleminderit, zoti Bejko, për praninë tuaj!

Në fakt, në vijim të asaj që tha zoti Gjoni, unë kam një pyetje: pse ne anëtarësohemi në këtë konventë kaq të rëndësishme kundër falsifikimit të monedhës tani në vitin 2019, pas 30 vjetëve demokraci? Pse kaq vonë? Nuk është menduar asnjëherë nga pala jonë, qoftë nga kjo qeveri apo qeveria tjetër, që ne të anëtarësohemi? Ka ardhur kaq vonë për shkak se është bërë problem i madh në kohën që jetojmë tani, pra, vitet e fundit kanë ndodhur ngjarje, të cilat tregojnë qartë që falsifikimi i monedhës është bërë një problem, apo thjesht është një gjë simbolike për të nderuar Mbretin Zog për anëtarësimin në vitin 1929?

Mimi Kodheli – Zoti Bejko, duke qenë se pyetja nuk është teknike, marr të drejtën të përgjigjem unë në vendin tuaj për këtë pyetje.

Bëhet fjalë për disa ndryshime strukturore në strukturat tona. Ne e kemi pak a shumë të sanksionuar në Kod, por që t'i përgjigjemi konventës ashtu siç duhet, kërkohet të bëhen disa ndryshime strukturore. Konventa është gjithmonë në përmirësim dhe kërkohet shumë punë. Ka shumë konventa të tjera në të cilat duhet të aderonim, zonja Hajdari, dhe nuk kemi aderuar ende.

Ne e kemi pasur në ligj, por edhe në Kod çështjen e falsifikimit të monedhës, por sot në Kod duhet të bëhen disa ndryshime që kanë të bëjnë me strukturat që do t'u përgjigjen këtyre ndryshime. Jam i saktë zoti Bejko?

Ilir Bejko – Mund të shtoj edhe diçka?

Do na japë mundësinë e shkëmbimit të informacionit me organet e vendeve të tjera, për të ecur paralelisht me falsifikatorët e monedhës dhe për të studiuar teknikat e fundit të tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Kemi ndonjë gjë tjetër të paqartë? Kolegë deputetë, mendoj ta hedhim në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Faleminderit!

Neni 2.

Faleminderit!

E votojmë në tërësi.

Faleminderit!

E konsiderojmë të miratuar.

Mbledhja mbyllet këtu

Ju falënderoj për seriozitetin dhe prezencën!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA